

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kz. Nr. 167/2012  
Prishtinë  
07 gusht 2012

Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancën e kolegjit në pajtueshmëri me Nenin 26 paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe Nenin 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhja e Lëndëve dhe Caktimi i Lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK) më 07 gusht 2012 në ndërtesën e Gjykatës Supreme, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar i kolegjit, Martti Harsia dhe Tore Thomassen gjyqtarë si edhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës Emine Mustafa dhe Salih Toplica si anëtarë të kolegjit,

Dhe me Zyrtarin Ligjor të EULEX-it Holger Engelmann si procesmbajtës,

Në praninë e

Prokurorit Publik ndërkombëtar Judith Eva Tatrai, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK)

Mbrojtësit, Gëzim Kollçaku avokat për të pandehurin Smajl GASHI,

Në lëndën penale me numër AP-KZ KA 602/11 resp. P.562/11 kundër të pandehurit:

S. G. lindur më [redacted] emri i të atit [redacted] emri i vajzërisë së nënës [redacted] me vendbanim në [redacted] shkollim të mesëm, punëtor në fushat e pllakave të qeramikës, me gjendje të mesme ekonomike, i pamartuar, pa fëmijë, aktualisht i paraburgosur në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë;

Në përputhshmëri me aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën nr. KA 602/11 resp. P.562/11 të datës 03 nëntor 2011 dhe të regjistruar të njëjtën ditë në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, i pandehuri është shpallur fajtor për veprat penale në vazhdim:

[i] për veprën penale **Krim i organizuar**, në kundërshtim të Nenit 274 paragrafi 3 të KPK, sepse nga 2008 deri më 2009 në Prishtinë, Pejë dhe në vende të tjera në dhe jashtë Kosovës ka organizuar, formuar dhe drejtuar aktivitetet e një grupi kriminal të organizuar që merret me trafikim të heroinës nga Kosova në Zvicër;

[ii] për veprën penale **Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave narkotike të rrezikshme**, në kundërshtim të Nenit 229 paragrafët 3 dhe 4 (I) të KPK, sepse prej 2008 deri në 2009, në Prishtinë, Pejë dhe në vende të tjera në Kosovë, duke vepruar si anëtarë i një grupi, në katër raste ka eksportuar nga Kosova në Zvicër sasi të papërcaktuara por relevante të heroinës;

**Dhe prandaj është dënuar me sa vijon:**

Për veprën penale **Krim i organizuar**, në kundërshtim të Nenit 274 paragrafi 3 të KPK, me 6 vjet burgim dhe një gjobë prej 10.000 Euro;

Për veprën penale **Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave narkotike të rrezikshme**, në kundërshtim të Nenit 229 paragrafët 3 dhe 4 (I) të KPK, me 4 vjet burgim dhe një gjobë prej 10.000 Euro.

Në pajtueshmëri me Nenin 71 paragrafët 1 dhe 2 të KPK, është caktuar një dënim unik prej 6 vjet dhe gjashtë muaj dhe gjobë prej 15.000 Euro.

Për më tepër është vendosur që gjoba duhet të paguhet brenda tre muajve nga dita kur aktgjykimi të marrë formën e prerë dhe në lidhje me burgimin, koha e kaluar në paraburgim nga i pandehuri nga 04 maj 2011 do të llogaritet atëherë kur aktgjykimi të marrë formën e prerë në pajtueshmëri me Nenin 391 paragrafi 1, nën-paragrafi 5 dhe Neni 278 paragrafi 7 të KPPK.

I pandehuri obligohet të mbuloj shpenzimet e procedurës penale në pajtueshmëri me Nenin 102 paragrafi 1 të KPPK me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit verbal dhe me shkrim.

**Avokati mbrojtës** i të pandehurit ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit në kohë me datën 26 mars 2012. Është pohuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është shumë i lartë dhe se *“fjalët ‘krim i organizuar’ duhet të hiqen sepse për këto fjalë janë të aplikueshme 7 vjet”*.

**PShRK** është përgjigjur në ankesën e avokatit mbrojtës më 26 prill 2012, duke vënë në pah mendimin e tyre sipas të cilit vendimi i Gjykatës së Qarkut është në pajtueshmëri me ligjin dhe se gjyqtari për konfirmim ishte kompetent për të dhënë aktgjykimin, për shkak të interpretimit të Nenit 308A të KPPK si *lex specialis* në lidhje me Nenet 309 deri më 317 të KPPK.

**ZPShK**, në përgjigjen e datës 31 maj 2012 dhe të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës më 4 qershor 2012 ka propozuar që pjesërisht të pranohet ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës dhe në pajtueshmëri me Nenin 420 paragrafi 1 pika 3 të KPPK, të priset aktgjykimi dhe lënda të kthehet te gjyqtari për konfirmim i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me udhëzimet si në vazhdim:

- a) Të vendoset për konfirmimin e aktakuzës (dhe eventualisht paraburgimin nëse skadon kur lënda është nën kompetencën e tij/të saj); dhe

- b) Të dërgohet lënda, atëherë kur – dhe nëse – aktakuza konfirmohet, te trupi gjykues për vendimin mbi Marrëveshjen e Pranimit të Fajësisë e arritur nga palët.

Bazuar në aktgjykimin me shkrim në lëndën KA 602/11 resp. P.562/11 të datës 03 nëntor 2011 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, ankesat me shkrim të dorëzuara të pandehurve, të dhënat relevante të lëndës dhe parashtrirat verbale të palëve gjatë seancës dëgjimore më 07 gusht 2012, bashkë me analizën e ligjit në fuqi, Gjykata Supreme pas këshillimit të mbajtur më 07 gusht 2012, lëshon këtë:

## AKTVENDIM

(1) Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 562/2011, i datës 3 nëntor 2011 *ex officio* ANULOHET dhe lënda kthehet në rigjykim.

(2) Ankesa e avokatit mbrojtës e ushtruar në emër të të pandehurit kundër aktgjykimin të lartë përmendur është jo lëndore.

## ARSYETIMI

### Historia e procedurës

Aktvendimi mbi fillimin e hetimit kundër të pandehurit është lëshuar më 14 janar 2010 nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, pasi një aktvendimi të tillë të parë i lëshuar më 23 shtator 2009 që doli të jetë i drejtuar kundër personit të gabuar, që mbante rastësisht të njëjtin emër sikurse i pandehuri.

Që nga 05 maj 2011 i pandehuri ishte vendosur dhe më vonë mbajtur në paraburgim, bazuar në seancën fillestare të paraburgimit më 5 maj 2011 dhe në disa aktvendime të shpallura mbi vazhdimin e paraburgimit. Me aktvendimin e lëshuar më 03 nëntor 2011 ishte caktuar paraburgimi derisa aktgjykimi të merrte formën e prerë.

Aktakuza është ngritur kundër të pandehurit në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë më 12 shtator 2011, duke e ngarkuar të pandehurin me **Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave narkotike të rrezikshme**, në kundërshtim të Nenit 229 paragrafët 3 dhe 4 (I) të KPK dhe me **Krim i organizuar**, në kundërshtim të Nenit 274 paragrafi 3 të KPK.

Është pohuar se i akuzuari i cili ishte arrestuar bashkë me dy shqiptarë të tjerë të Kosovës në Zvicër më 18 janar 2009, ishte përfshirë në trafikimin e 12,5 kg heroin, ku kjo e fundit është konfiskuar në rastin e përmendur. Sipas informatave të marra nga autoritetet zvicerane, i pandehuri gjoja ishte njëri nga organizatorët e trafikimit të drogës nga Kosova përmes vendeve të Evropës perëndimore dhe vepronte me mbështetjen e bashkëpunëtorëve të tjerë.

Seanca e parë e konfirmimit të aktakuzës ishte caktuar te gjyqtari për konfirmim në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë më 26 tetor 2011, dhe nga palët ishte paraqitur Marrëveshja e Pranimit të Fajësisë dhe që ishte pranuar nga gjyqtari.

Më 03 nëntor 2011 seanca e konfirmimit të aktakuzës u mbajt në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. I pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës hoqën dorë nga seanca e konfirmimit të aktakuzës dhe seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe kërkuan dhënien e vendimit për dënimin në linjë me Marrëveshjen e Pranimit të Fajit.

Bazuar në Nenin 308A paragrafi 15 të KPPK (dhe duke pasur parasysh po ashtu paragrafin 12 të të njëjtës dispozitë), gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë lëshoi aktgjykimin e kundërshtuar në fund të seancës së konfirmimit të aktakuzës më 03 nëntor 2011.

**Avokati mbrojtës i të pandehurit** në kohë ka ushtruar ankesë më datën 26 mars 2012 kundër aktgjykimit dhe vuri në pah sikurse u theksua më sipër.

**PSRK** u përgjigje në ankesën e avokatit mbrojtës më 26 prill 2012, duke theksuar në këtë mënyrë interpretimin e tyre sipas të cilit fjala 'gjykatë' e përdorur në Nenin 308A paragrafi 15 të KPPK mund të kuptohet në mënyrë autonome nga struktura e KPPK brenda kontestit të Ligjit Nr. 03/L-003 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale Nr. 2003/26, të datës 6 nëntor 2008.

**ZPShK**, me përgjigjen e datës 31 maj 2012 dhe të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës më datë 04 qershor 2012 ka propozuar që pjesërisht të pranohet ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës sikurse u theksua më sipër.

## **GJETJET E GJYKATËS**

### **A. Ankesa e ushtruar në kohë:**

Çështja ka të bëjë nëse ankesa e datës 26 mars 2012 e ushtruar nga avokati mbrojtës kundër vendimit të kundërshtuar është ushtruar në kohë në pajtueshmëri me Nenin 398 paragrafi 1 të KPPK.

Gjykata Supreme konstaton se asnjë informacion tjetër nuk mund të nxirret nga shkresat e lëndës veç atij se aktvendimi i kundërshtuar i është dërguar të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës më 16 mars 2012, që shkon në favor të të pandehurit se ankesa e datës 26 mars 2012 ishte ushtruar brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditë nga dita kur "*një kopje e aktgjykimit ishte dërguar*", kështu që duhet të konsiderohet e ushtruar në kohë.

### **B. Shkelje esenciale e dispozitave të Procedurës Penale**

Përkundër faktit se edhe dispozitivi i vendimit të kundërshtuar është i pamjaftueshëm dhe në mospërputhshmëri me kushtet e ligjit, në të cilën e gjithë referenca për çfarëdo fakti

vendimtar është zhdukur, fokusi i Gjykatës Supreme në lëndën në fjalë në mënyrë ekskluzive i referohet pyetjes nëse gjyqtari i konfirmimit të aktakuzës mundë të jetë kompetent që menjëherë të lëshoj një aktgjykim. Edhe pse çështja nuk është ankimuar nga mbrojtja, gjykata e shkallës së dytë duhet të shqyrtoj këtë aspekt të aktgjykimit *ex officio* sipas Nenit 415 paragrafi 1 pika 1 të lexuar në lidhje me Nenin 403 paragrafi 1 pika 1 të KPPK. Përveç kësaj, çështja po ashtu është kundërshtuar nga mendimi i ZPSHK i datës 31 maj 2012.

#### I. PËRPARËSIA E VERSIONIT ANGLISHT, SHQIP APO SERBISHT E NENIT 308A TË KPPK:

Para një vendimi material dhe në sfondin e Nenit 556 të KPPK ngrihet pyetja nëse mbizotëron versioni në anglisht, shqip apo serbisht i Nenit 308A të KPPK. Përderisa sipas versionit në anglisht të Nenit 308A paragrafi 1 të KPPK negociatat mbi konditat e marrëveshjes me shkrim të pranimit mund të zhvillohen “[n]ë çdo kohë pas ngritjes së aktakuzës dhe para përfundimit të gjykimit”, version në Shqip dhe Serbisht i të njëjtës dispozitë parasheh që negociatat në lidhje me marrëveshjen e pranimit të fajësisë “mund të fillojnë vetëm pas konfirmimit të aktakuzës dhe para fillimit të shqyrtimit gjyqësor”. Dallimi në mes të dy versioneve mund të konstatohet qartë në faktin se sipas versionit në Shqip dhe Serbisht të ligjit madje edhe në rastin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë, gjyqtari i konfirmimit të aktakuzës është i kufizuar në rolin e tij sikurse përcaktohet me Ligj dhe prandaj supozohet të përfundoj fazën e konfirmimit të lëndës me një aktvendim të duhur, para se pasojat e marrëveshjes së pranimit të fajit mund të vlerësohen gjatë zhvillimit të seancës së shqyrtimi gjyqësor, përderisa versioni në Anglisht jep përshtypjen se pas ngritjes së aktakuzës, lënda mund të finalizohet në mënyrë të duhur bazuar në marrëveshjen e pranimit të fajësisë por jo medoemos vetëm në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata Supreme konstaton se përkundër Nenit 556 të KPPK sipas të cilit “Versionet në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe do të jenë njësoj autentike” por se “[n]ë rast mosmarrëveshjeje, mbizotëron versioni në gjuhën angleze”, nuk vlen në lëndën në fjalë dhe se në lidhje me Nenin 308A të KPPK patjetër mbizotëron versioni në gjuhën shqipe i dispozitës. Ky interpretim bazohet në faktin se KPPK si tërësi në versionin e tij fillestar d.m.th duke përfshirë Nenin 556 të KPPK të referuar, është zbatuar si një Rregullore e UNMIK-ut në vitin 2004, fillimisht në gjuhën angleze por që Neni 308A të KPPK është paraqitur nga Ligji Nr. 03/L-003 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale Nr. 2003/26, të datës 06 nëntor 2008, e që ky i fundit në versionin e tij fillestar është një Ligj i Kosovës, i hartuar në gjuhën shqipe.

## II. ROLI I GJYQTARIT PËR KONFIRMIM TË AKTAKUZËS NË PËRPUTHJE ME NENIN 308 A TË KPPK-së:

Gjykata Supreme gjen se neni 308A paragrafi 15 i KPPK-së i paraqitur me nenin 6 të Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës Nr. 2003/26 (Ligji Nr. 03/L-003), të datës 06 nëntor 2008, nuk i jep bazë ligjore gjyqtarit për konfirmim të aktakuzës të lëshojë aktgjykim. Kjo është shumë e qartë dhe nuk ka nevojë për interpretim të mëtutjeshëm duke marrë parasysh versionet e dispozitës në gjuhët e referuara shqipe dhe serbe. Megjithatë, as versioni në gjuhën angleze nuk lejon asnjë interpretim tjetër.

Në lëndën konkrete, gjyqtari për konfirmim të aktakuzës ka vlerësuar nëse janë plotësuar të gjitha kushtet dhe kërkesat e ligjit përkitazi me marrëveshjen për pranimin e fajësisë në përputhje me nenin 308A paragrafin 12 të KPPK-së. Pasi gjyqtari për konfirmim të aktakuzës ishte i bindur se marrëveshja për pranimin e fajësisë e paraqitur ishte në pajtim me kushtet ligjore të përmendura, ai e pranoi atë në përputhje me nenin 308A paragrafin 15 të KPPK-së dhe dha urdhër të vendoset në shkresat e lëndës në gjykatë.

Megjithatë, gjyqtari për konfirmim të aktakuzës më pas ka vazhduar të procedojë siç sugjerohet me nenin 308A paragrafin 15 të KPPK-së dhe – pasi palët dhanë deklaratat e tyre – në vend se të merr një aktvendim në pajtim me nenin 309 e tutje të KPPK-së, ai mori një aktgjykim dhe të pandehurit i shqiptoi një dënim, duke e lexuar dispozitën e nenit 308A paragrafit 15 të KPPK-së si bazë ligjore për atë që ta shkurtojë procedurën penale gjyqësore dhe të jetë kompetent të merr aktgjykimin menjëherë, por pa mbajtur seancë të shqyrtimit gjyqësor.

Neni 308A paragrafi 15 i KPPK-së (në version të gjuhës angleze) thotë siç vijon:

*Nëse gjykata është e bindur se të gjitha kushtet e parapara në paragrafin 12 të këtij neni janë përmbushur, gjykata mund ta pranoj marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe do të urdhëroj që marrëveshja të vendoset në shkresat e lëndës në gjykatë. Gjykata do të caktojë një datë kur palët do të japin deklaratat e tyre në lidhje me dënimin pas së cilës gjykata do të shqiptojë dënimin. Megjithatë, kjo datë mund të shtyhet në mënyrë që i akuzuari të shërbejë si dëshmitar bashkëpunues.*

Për zgjidhjen e kësaj çështjeje është vendimtare, se a konsiderohet apo nuk konsiderohet gjyqtari për konfirmim të aktakuzës si 'gjykatë' në kuptim të nenit 308A paragrafit 15 të KPPK-së. Vetëm në këtë rast, kompetenca e gjyqtarit për konfirmim të aktakuzës për marrjen e një aktgjykimi mund të burojë prej kësaj dispozite.

Përgjigja mund të gjendet përmes analizës ligjore dhe interpretimit të ligjit duke u bazuar në formulimin e dispozitës përkatëse, kontekstit të tij sistematik dhe *ratio legis* të saj.

1. **Formulimi i nenit 308A paragrafit 15 të KPPK-së** parasheh që 'gjykata' të shqiptojë dënimin ndaj të pandehurit. Prandaj, duhet të ngrihet çështja a mund apo nuk mund konsiderohet gjyqtari për konfirmim të aktakuzës si 'gjykatë' në këtë kuptim.

Edhe pse ligji nuk parasheh asnjë definicion ligjor se çka është 'gjykatë', megjithatë mund të gjendet një përgjigje në leximin e nenit 151 të KPPK-së mbi definicionet ligjore, i cili nën pikën 12 parasheh se "[t] termi *"seancë konfirmimi"* është seancë ku gjyqtari merr aktvendim mbi aktakuzën dhe të pandehurit i jepet mundësia për ta pranuar apo mos pranuar fajësinë [...]", kurse në përputhje me pikën 14 të dispozitës së njëjtë "[t] termi *"kryetari i trupit gjykues"* është kryetari i trupit gjykues, gjyqtari i vetëm kur procedura zbatohet sipas nenit 22 paragrafit 2 të këtij Kodi, gjyqtari i vetëm i cili zbaton procedurën për konfirmimin e aktakuzës ose kryetar i trupit gjykues i një kolegj të apelit apo një kolegj i cili vendos për mjetin e jashtëzakonshëm juridik".

Formulimi i dispozitës bashkë me formulimin e dispozitave të tjera përkatëse të KPPK-së përkitazi me fazën e konfirmimit të aktakuzës nuk parasheh interpretim sipas të cilit neni 308A paragrafi 15 i KPPK-së dëshiron të prezantojë një 'marrëveshje' specifike ndryshe nga pranimi i rregullt i fajësisë, siç sugjerohet nga PSRK-ja në mendimi e tyre të datës 26 prill 2012. Kjo e fundit në veçanti bëhet e qartë kur analizohet konteksti sistematik dhe *ratio legis* i nenit 308A paragrafit 15 të KPPK-së lidhur me fazën e konfirmimit të aktakuzës në përgjithësi.

Nga kjo – si dhe nga përdorimi i termit 'aktgjykimi i formës së prerë' në nenin 151 pika 13 e KPPK-së rrjedh se gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës ka vetëm kompetenca të kufizuara, të cilat nuk mund të tejkalohen përtej fazës së konfirmimit të secilës lëndë dhe se veçanërisht ai/ajo nuk mund të konsiderohet si "gjykatë" në kuptimin e nenit 308A paragrafit 15 të KPPK-së.

- 2. Konteksti sistematik i nenit 308A të KPPK-së** në mes dispozitave për seancën e konfirmimit nuk lejon të përfundohet se gjyqtari për konfirmim të aktakuzës nën rrethana të caktuara është i autorizuar të merr menjëherë aktgjykim, duke privuar të pandehurin nga shumë mjete juridike dhe mundësi të tjera për ta mbrojtur veten gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor dhe më tutje. Nga konteksti sistematik i nenit 308A të KPPK-së mund vetëm të arrihet në përfundim se kjo dispozitë përshkruan kompetencat e gjyqtarit për konfirmimi të aktakuzës, kur është arritur marrëveshja mbi pranimin e fajësisë dhe deri në pikën kur gjyqtari është i bindur me marrëveshjen dhe e pranon atë. Duke pasur parasysh se neni 308 A i KPPK-së paraqitet vetëm si plotësim i dispozitave mbi fazën e konfirmimit të aktakuzës siç përcaktohet me nenet 309 deri 318 të KPPK-së, bëhet e qartë se kompetenca e gjyqtarit për konfirmimi të aktakuzës është e kufizuar në zhvillimin e seancës së konfirmimit – bazuar në rezultatet e saj – me marrjen e aktvendimit mbi konfirmimin, pra me konfirmimin ose refuzimin e aktakuzës. Po ashtu është e qartë përtej çdo dyshimi se i pandehuri në fazën e konfirmimit të aktakuzës me disa kushte të caktuara mund të heqë dorë nga e drejta e tij t'i nënshtrohet seancës së konfirmimit dhe të kërkojë rishikim të aktakuzës bashkë me provat e paraqitura. Megjithatë, veçanërisht neni 311 paragrafi 2 i KPPK-së qartazi thotë se gjyqtari për konfirmim të aktakuzës në këtë rast merr një aktvendim për pranimin e heqjes dorë. Po ashtu vendimi mbi konfirmimin e aktakuzës duhet të merret në formë të aktvendimit, në përputhje me nenin 312 të KPPK-së, e ndaj të cilave mund të

ushtrohet ankesë në përputhje me nenin 317 paragrafin 2 dhe nenet 431 e tutje të KPPK-së. Nuk është kontestuese se i pandehuri mund natyrisht të heqë dorë nga e drejta e tij/saj për ta kundërshtuar aktakuzën dhe provat, por asgjë tjetër e sidomos jo shqyrtimin gjyqësor.

3. **Ratio legis i nenit 308A të KPPK-së**, nga pikëpamja e asaj që më parë, duhet të jetë i kufizuar në mundësinë e shmangies së procedurës së zgjatur e të detajuar të konfirmimit të aktakuzës në lëndët, kur provat dhe pjesëmarrja e të pandehurit në veprimtari penale janë thjesht të pakontestueshme. Vetëm në këtë mjedis kjo dispozitë mund të lexohet si *lex posterior* dhe *lex specialis* për të gjitha dispozitat e tjera lidhur me procedurën e konfirmimit siç sugjerohet nga PSRK-ja në mendimin e tyre të datës 26 prill 2012.

KPPK-ja nuk parashihet strukturë ligjore njëjtë me mjetin e ‘urdhrit të dënimit’ të njohur për disa shtete të Evropës siç është Gjermania, brenda së cilës urdhri për dënim me shkrim në disa raste të caktuara të definuar qartë mund të dërgohet te i pandehuri, me kusht që të mos pritët një dënim më i madh se me gjobë ose një dënim afatshkurtër jo më shumë se me gjashtë muaj burgim. Kjo bëhet e qartë në veçanti duke pasur parasysh se ligji nuk parashihet asnjë mundësi për të hequr dorë edhe nga shqyrtimi gjyqësor si të përjashtuar gabimisht me aktgjykimin e kundërshtuar (faqe 1 e aktgjykimit të kundërshtuar në versionin e saj në gjuhën angleze) në lëndën konkrete. Një ide kryesore prapa këtij fakti mund natyrisht të konsiderohet se shqyrtimi gjyqësor garanton një vlerësim të kujdesshëm dhe shumë më të thellë të fakteve dhe provave, pasi mund të zhvillohet nga gjyqtari (i vetëm) për konfirmim gjatë vlerësimit përmbledhës.

Kjo është e vërtetë veçmas në rastin si në lëndën konkrete, ku edhe akuzat për krim të organizuar të pretenduar janë në diskutim e sipër, ku dënimi maksimal deri në 20 vjet është në pyetje dhe kolegji i pesë gjyqtarëve duhet të vendosë lidhur me lëndën në fazën e shqyrtimit gjyqësor, në përputhje me nenin 24 të KPPK-së<sup>1</sup>.

Në anën tjetër, ligji e armatos të pandehurin me një numër mjetesh juridike gjatë zhvillimit të seancës së shqyrtimit gjyqësor si dhe në lidhje me vendimin përfundimtar, të cilat mund të ndërpriten të gjitha me mundësinë e heqjes dorë nga seanca e shqyrtimit gjyqësor e cila tanimë është në fazën e konfirmimit.

Prandaj, marrja e aktgjykimit nga gjyqtari për konfirmim në lëndën konkrete paraqet shkeljen më të rëndë të dispozitave të procedurës penale, sipas nenit 403 paragrafit 1 pika 1 e KPPK-së, dhe për këtë arsye aktgjykimi i kundërshtuar duhet të anulohet dhe të kthehet në Gjykatë të Qarkut për procedurë të drejtë.

### C. Shkelje substanciale të ligjit penal

Duke i marrë parasysh gjetjet e sipërpërmendura, në rastin konkret mbetet e hapur, a është shkelur apo nuk është shkelur edhe ligji penal nga Gjykata e Qarkut, pasi që në veçanti

---

<sup>1</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 mbi caktimin e gjyqtarëve/prokurorëve ndërkombëtarë dhe ndërrimin e vendeve të tyre, neni 2.1 lidhur me nenin 3.7 të ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, në rast të pjesëmarrjes së gjyqtarëve ndërkombëtarë në këtë situatë përcakton një kolegji prej vetëm tre gjyqtarëve profesionalë.



është kundërshtuar nga avokati mbrojtës, duke theksuar se "fjalët 'krim i organizuar' duhet të zhduken sepse qe 7 vjet këto fjalë janë të zbatueshme".

#### **D. Vendimi mbi dënimin**

Duke i marrë parasysh gjetjet nga pika A të këtij aktvendimi, Gjykata Supreme nuk merr asnjë qëndrim se a është i drejtë e i balancuar dënimi apo nuk është. Vendimi përkitazi me këtë do të jetë çështje e seancës së mundshme të shqyrtimit gjyqësor, në rast se konfirmohet aktakuza.

Për këto arsye Gjykata Supreme vendos si në dispozitiv.

#### **Anëtarët e kolegjit:**

---

**Emine Mustafa**  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

---

**Martti Harsia**  
Gjyqtar i EULEX-it

---

**Salih Toplica**  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

---

**Tore Thomassen**  
Gjyqtar i EULEX-it

#### **Kryetar i kolegjit:**

Procesmbajtës:

---

**Gerrit-Marc Sprenger**  
Gjyqtar i EULEX-it

---

**Holger Engelmann**  
Zyrtar ligjor i EULEX-it

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**AP.-KŽ. Nr. 167/2012**  
**Prishtinë**  
**07 gusht 2012**

